



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 539 Akti

**Nr . 642 Vendimi
Tiranë, më 6.4.2023**

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Valbona Sanxhaktari	Kryesuese
Etleda Çiftja	Relatore
Suela Zhegu	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Resilda Bilaj, në prezencë edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Elka Ermenkova, në datën 6.4.2023, mori në shqyrtim mbi bazën e dokumenteve të administruara çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Ded Miri**, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë** dhe nenet A, B, C, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoji relatoren e çështjes, komisioneren Etleda Çiftja, mori në shqyrtim dhe analizoi vendimin nr. ***, datë 13.3.2023, të Këshillit të Lartë të Gjyqësor, me të cilin është vendosur mbarimi i statusit të magjistratit për shkak të mbushjes së moshës së pensionit të pleqërisë të z. Ded Miri, si dhe pasi bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT PROCEDURALE

1. Z. Ded Miri, në momentin e hyrjes në fuqi të nenit 179, germa “b” e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, ka mbajtur funksionin e gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, për rrjedhojë, në zbatim të pikës 3 të kësaj dispozite dhe parashikimit të nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, gëzon statusin e subjektit të rivlerësimit dhe i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*.

2. Subjekti i rivlerësimit Ded Miri, bazuar në nenin 14 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit, duke u shortuar në datën 15.6.2020, me trupin gjykues të përbërë nga komisionerët Suela Zhegu, Alma Faskaj dhe Etleda Çiftja.

3. Menjëherë pas hedhjes së shortit u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), sipas neneve 31 - 33 të ligjit nr. 84/2016; Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK), sipas neneve 34 - 39 të ligjit nr. 84/2016; si dhe nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, sipas neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016.

4. Trupi gjykues i shortuar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit me vendimin datë 15.06.2020 pas studimit të raporteve të sipërpërmendura të vlerësimit, të hartuara nga institucionet shtetërore, vendosi të fillojë hetimin administrativ të thellë dhe të gjithanshëm sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit. Të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit. Nga ana e relatores së çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në nenin 14, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, si dhe është njoftuar subjekti i rivlerësimit për përbërjen e trupit gjykues.

5. Bazuar në rekomandimin e Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, si dhe në kërkesën e relatores së çështjes Etleda Çiftja, Komisioni, në mbledhjen e datës 28.9.2022, me vendimin nr. ***, datë 28.9.2022, ka vendosur zëvendësimin me short të komisioneres Alma Faskaj. Pas procedurës së shortit, anëtare zëvendësuese rezultoi komisionere Valbona Sanxhaktari.

6. Në vijim të procesit të rivlerësimit, gjatë shqyrtimit të dokumentacionit për subjektin e rivlerësimit Ded Miri, Komisioni konstatoi se ky subjekt rivlerësimi në datën 5.3.2023 mbush moshën për pension pleqërie. Nisur nga ky fakt dhe parashikimet ligjore përkatëse, Komisioni çmoi të nevojshme t'i drejtohej me anë të shkresës nr. *** prot., datë 24.10.2022, Këshillit të Lartë Gjyqësor, për të marrë informacion nëse nga ana e z. Ded Miri është paraqitur ndonjë kërkesë për qëndrim në detyrë sipas parashikimit të pikës 5, neni 64 i ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve edhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, duke qenë se ky magjistrat mbush moshën për pension pleqërie në datën 5.3.2023.

7. Këshilli i Lartë Gjyqësor, me shkresën nr. *** prot., datë 28.10.2022, njoftoi Komisionin se nga kontrolli i regjistrimit të korrespondencës së zyrës së protokollit nuk rezultoi që subjekti i rivlerësimit të ketë paraqitur kërkesë për të vijuar ushtrimin e detyrës deri në moshën 70 vjeç, bazuar në nenin 64, pika 5 e ligjit nr. 96/2016.

8. Komisioni ka pasur disa komunikime me Këshillin e Lartë Gjyqësor lidhur me këtë proces për subjektin e rivlerësimit, me anë të shkresës nr. *** prot., datë 3.3.2023, ka kërkuar të vihet në dispozicion vendimi i KLGJ-së për mbarimin e statusit të magjistratit për z. Ded Miri, si dhe kërkesën për mbarimin e statusit të magjistratit mbi motivin “arritja së moshës së pensionit”, me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

9. Në vijim, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka informuar Komisionin me shkresën nr. *** prot., datë 7.3.2023, se pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, në datën 22.2.2023, është depozituar një kërkesë me shkrim protokolluar me aktin nr. ***, datë 22.2.2023, nga gjyqtari Ded Miri, përmes së cilës vë në dijeni Këshillin e Lartë Gjyqësor për mbarimin e statusit të magjistratit si shkak i mbushjes së moshës për pension pleqërie në datën 5.3.2023. Kjo kërkesë i ka kaluar për trajtim Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

10. Në vijim, Këshilli i Lartë Gjyqësor, me anë të shkresës nr. *** prot., datë 21.3.2023, njoftoi Komisionin se pas shqyrtimit në mbledhjen e datës 13.3.2023, Këshilli vendosi deklarin e mbarimit të statusit të magjistratit për z. Ded Miri, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, për shkak të mbushjes së moshës së pensionit të pleqërisë. Bashkëlidhur është njoftuar vendimi nr. ***, datë 13.3.2023, i Këshillit të Lartë Gjyqësor, “Për mbarimin e statusit të magjistratit”, duke deklaruar mbarimin e statusit të magjistratit, të z. Ded Miri, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin, për shkak të mbushjes së moshës së pensionit të pleqërisë. Efektet e këtij vendimi fillojnë në datën 31.3.2023.

11. Me qëllim konkludimin brenda procedurave të një procesi të rregullt ligjor dhe respektimin e të drejtës së subjektit për t’u dëgjuar, bazuar në nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në datën 3.4.2023, nëpërmjet postës elektronike, i kërkoi subjektit të rivlerësimit të shprehte vullnetin e tij lidhur me paraqitjen në seancë publike për t’u dëgjuar lidhur me mbarimin e statusit të tij si magjistrat, si dhe të deklaronte nëse kishte ushtruar ankim ndaj vendimit të lartpërmendur të KLGJ-së.

12. Subjekti i rivlerësimit, duke u përgjigjur nëpërmjet postës elektronike të datës 5.4.2023, bëri me dije se nuk ishte i interesuar të merrte pjesë në seancë dëgjimore dhe se nuk kishte ushtruar ankim ndaj vendimit nr. ***/2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, duke konfirmuar dhe rishprehur kështu vullnetin e tij të pavesuar në raport me mbarimin e statusit të magjistratit.

13. Nisur nga sa më sipër, Komisioni vlerëson se në mënyrë të përmbledhur janë konstatuar këto fakte: (i) subjekti i rivlerësimit ka kërkuar mbarimin e statusit të magjistratit me mbushjen e moshës 67 vjeç, duke i drejtuar kërkesë Këshillit të Lartë Gjyqësor; (ii) Këshilli i Lartë Gjyqësor, me vendimin nr. ***, datë 13.3.2023, ka vendosur deklarin e mbarimit të statusit të magjistratit, për shkak mbushjes së moshës 67 vjeç, për z. Ded Miri; (iii) vendimi nr. ***, datë 13.3.2023, i Këshillit të Lartë Gjyqësor, për

mbarimin e statusit të magjistratit, ka marrë formë të prerë. Veprimet janë në harmoni me dispozitat e nenit 64 të ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar. Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se këto rrethana përbëjnë shkak për përfundimin e procesit të rivlerësimit për z. Ded Miri, pa një vendim përfundimtar.

II. ARSYET E PËRFUNDIMIT TË PROCESIT TË RIVLERËSIMIT

14. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues që mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

15. Trupi gjykues konstaton se z. Ded Miri ka qenë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin, duke qenë kështu në rrethin e subjekteve të rivlerësimit që i nënshtrohen procesit të rivlerësimit *ex officio*.

16. Këshilli i Lartë i Gjyqësor, me vendimin nr. ***, datë 13.3.2023, ka vendosur të deklarojë mbarimin e statusit të magjistratit për z. Ded Miri, për shkak të mbushjes së moshës së pensionit të pleqërisë, vendim i cili i është njoftuar edhe Komisionit.

17. Bazuar në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 64, pika 1, germa “c”, përcaktohet se: “*Statusi i magjistratit mbaron në rastet kur: ... c) mbush moshën e pensionit të pleqërisë, sipas parashikimit të këtij ligji [...]*”.

18. Në nenin 64, pika 5 e ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, është parashikuar procedura që duhet ndjekur për mbarimin e statusit të magjistratit, i cili plotëson kushtet e parashikuara në ligj për daljen në pension pleqërie, si vijon: “*5. Magjistrati del në pension pleqërie në moshën 67 vjeç. [...] Statusi i magjistratit mbaron kur mbush moshën 67 vjeç ...[...]. Këshilli deklaron me vendim mbarimin e statusit të magjistratit, jo më vonë se dy javë para fundit të muajit përkatës*”.

19. Në kushtet kur subjekti i rivlerësimit, për shkak të mbushjes së moshës së pensionit të pleqërisë, 67 vjeç, ka shprehur vullnetin e tij për të mos vazhduar ushtrimin e detyrës, rast në të cilin, sipas përcaktimit ligjor, mbarimi i statusit të magjistratit deklarohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor e, në aplikim të nenit 64, pika 1, germa “c” e ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar, i ka mbaruar statusi i magjistratit pikërisht për këtë shkak ligjor.

20. Nisur nga fakti se subjektit të rivlerësimit i ka mbaruar statusi i magjistratit për një nga rastet e parashikuara nga ligji, Komisioni vlerëson se bazuar në ligjin nr. 84/2016, në pikën 6 të nenit 4, ku parashikon se kur është rasti, institucionet e rivlerësimit mund të zbatojnë procedurat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, nëse këto procedura nuk janë parashikuar nga dispozitat e Kushtetutës ose të këtij ligji.

21. Në rastin konkret çmohet i aplikueshëm neni 95 i Kodit të Procedurave Administrative, pasi objekti për të cilin kishte nisur procedura e rivlerësimit kalimtar apo qëllimi i këtij procesi rivlerësimi është bërë i pamundur, pasi subjektit i ka mbaruar statusi i magjistratit për shkak të mbushjes së moshës së pensionit. Konkretisht, bazuar në parashikimin e nenit

95 të Kodit të Procedurës Administrative, “Pamundësia në objekt apo qëllim”, ku specifikohet se: “*Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur*”, vlerëson se objekti dhe qëllimi që synon procedura e rivlerësimit është bërë i pamundur.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në nenin 4, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, germa “c” e pikës 1 e nenit 64 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në nenin 95 të Kodit të Procedurave Administrative,

V E N D O S I:

1. Të deklarojë përfundimin e procesit të rivlerësimit për z. Ded Miri, pa një vendim përfundimtar, për shkak se objekti për të cilin ka nisur procedura e rivlerësimit kalimtar është bërë i pamundur.
2. Ky vendim u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ndaj këtij vendimi mund të ushtrohet ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 6.4.2023.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Valbona SANXHAKTARI

Kryesuese

Etleda ÇIFTJA

Relatore

Suela ZHEGU

Anëtare

Sekretare gjyqësore
Resilda Bilaj